



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva- Ministry of Health

HULUMTIMI PËR QASJE NË IPSH PËR PAK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Prishtinë, 2016



Hulumtimi i IPSH-Regjionet:

- Prishtinë
- Prizren
- Ferizaj
- Pejë
- Gjilan
- Gjakovë
- Mitrovicë

Përmbajtja

1.FALENDERIM

2.PARATHËNIE

3.SHKURTESAT

4. HYRJE

- PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR
- INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE TË TRAJTUARA NË HULUMTIM
- ECURIA E PUNËS SË KOMISIONIT

5. PREZENTIMI I GRAFIKONEVE TË HULUMTIMIT

6. PYETËSORI I PËRDORUR GJATË HULUMTIMIT

7. KONKLUZIONI

Falënderim

Ky raport u hartua falë kontributit që kan dhënë antarët e Komisionit të aprovuar nga Sekretari i Pergjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, ku është formuar grupi teknik për vlerësimin e qasjes fizike të Institucioneve shëndetësore publike në Republikën e Kosovës të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar, në këtë përbërje:

Musë Shigjeqi –kryesues i Grupit

Arif Alimusaj –anëtar

Sanie Kiçmari –anëtare

Niman Bardhi –anëtar

I njëjti Komision ka hartuar pyetësorin dhe ka mbajtur takime paraprake me zyrtaret në ISHP të cilët kanë plotësuar pyetësoret .

Falenderojm drejtuesit e Institucioneve Shëndetësore, stafin profesionist shëndetsorë të cilet i kanë plotësuar pyetësoret si dhe të gjithë ata të cilit kanë bashkëpunuar deri në raportin përfundimtar të hulumtimit .

Parathënia

Publikimi për krijimin e mundësive për qasjen fizike të personave me aftësi të kufizuara përfshin të dhëna relevante aktuale lidhur me tematiken tejet të rëndësishme me të cilën preket segmenti më i rëndësishëm të shoqërisë, krijimi i mundësive për qasje fizike në Institucionet Shëndetësore Publike.

Ky dokument do të shërbej si udhëzues për zbatimin e praktikave sa më të mira në implementimin e ligjit dhe standardeve ndërkombëtare, për zhvillimin e politikave me të mira të shëndetësisë dhe për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara.

Shpresojmë që ky hulumtim do të shërbej tek institucionet tona si pikënisje e përmirësimit të gjendjes aktuale shëndetësore, dhe të kontribuojë në përmirësimin e qasjes fizike të PAK në Institucionet Publike në Republikën e Kosovës.

SHKURTESAT

MSh– Ministria e Shëndetësisë

IKSHPK–Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës

SHSKUK– Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës

SR- Spitalet Regjionale

QSHM- Qendra e Shëndetit Mendor

QKMF- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

QMF- Qendra e Mjekësisë Familjare

AMF- Ambulanca e Mjekësisë Familjare

IPSH- Institucionet Publike Shëndetësore

PAK- Personat me Aftësi të Kufizuar

SHIB- Shtëpia Integruese në Bashkësi

HYRJA

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të shërbej si burim referimi Institucioneve të Republikës së Kosovës, gjegjësisht Institucioneve Publike Shëndetësore për gjendjen aktuale të qasshmërisë fizike në Institucionet Publike Shëndetësore (IPSH) me synim që në të ardhmen të intervenohet në përmirësimin e gjendjes aktuale.

Është me rëndësi të theksohet se ky hulumtim përmban definicionin lidhur me personat me aftësi të kufizuar, bazuar në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar si dhe legjislacionin aktual, ecurinë e punës së Komisionit që nga themelimi deri në përfundimin e punës në teren.

Hulumtimi është i prezantuar në formë të grafikoneve me përqindje të qasshmërisë në Institucionet Publike Shëndetësore sipas niveleve të kujdesit shëndetësor.

Gjithashtu, në këtë hulumtim gjeni formën e pyetësorit që është plotësuar nga të gjitha IPSH lidhur me qasjen në Institucionet Shëndetësore në secilin objekt, si dhe konkluzionin.

- **PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR**

Personat me aftësi të kufizuar janë personat me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjate që në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri. Këtë definicion e ka dhënë Konventa Për Të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Legjislacioni i Republikës së Kosovës, aftësinë e kufizuar e definon si: *“Kufizimi i qasjes dhe aktiviteteve të zakonshme në jetën e përditshme të një personi, si pasojë e dëmtimeve fizike, shqisore ose mendore, që e pengojnë atë për pjesëmarrje në aktivitet e zakonshme ditore. Ndërsa, “Personat me aftësi të kufizuara” janë ata persona që kanë dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afat-gjate, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabartë me të tjerë. Personat me aftësi të kufizuara fizike janë personat të cilët si shkak i sëmundjeve, aksidenteve apo trashëgimisë, kanë dëmtime trupore afatgjate, të cilat kufizojnë funksionimin fizik të një a më shumë gjymtyrëve, ose aftësive motorike që përfshinë dëmtim të muskujve dhe humbje të ndjeshmërisë së ekstremiteteve.*

- **ECURIA E PUNËS SË KOMISIONIT**

Duke u bazuar në Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës (2013-2015) objektivin specifik 2: Huluntimi dhe përmirësimi i qasjes në Institucionet Shëndetësore për personat me aftësi të kufizuar të objektivit Strategjik 5 të Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të kufizuar në Republikën e Kosovës (2013-2023),

Divizioni për të Drejtat e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor në bazë të këtij Plani ka bërë kërkesën në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë për projekt-propozimin e qasjes fizike në Institucionet shëndetësore publike të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar.

Pas aprovimit të Projekt-propozimit me numër protokolli 05-710 të datës 10.02.2015 nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, është formuar Grupi Teknik për vlerësimin e qasjes fizike të institucioneve shëndetësore publike në Republikën e Kosovës të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar, në këtë përbërje:

Musë Shigjeqi –kryesues i Grupit

Arif Alimusaj –anëtar

Sanie Kicmari –anëtare

Niman Bardhi –anëtar.

Komisioni ka hartuar pyetësin për vlerësimin e qasjes fizike të Institucioneve shëndetësore publike në Republikën e Kosovës të përshtatshme për PAK .

Pyetësi është plotësuar gjatë vitit 2015 në të gjitha Regjionet në Institucionet Shëndetësore në Republikën e Kosovës .

Anëtarë të Grupit teknik kanë pasur regjionet e ndara, dhe kanë shpërndarë pyetësit në secilin regjion, në secilin Institucion Shëndetësor si në (Instituti/ Spitali Regjional/ Departamenti-reparti/ ambulanca specialiste/ QKMF/ QMF/ AMF/ QSHM/ SHIB/ shërbime/ dhe shërbime tjera).

Secili Institucion Shëndetësor ka qenë i njoftuar për procedurën që do ta zhvillojë deri në plotësimin e të dhënave.Përsoni përgjegjës që ka plotësuar pyetësin ka pasur njohuri lidhur me infrastrukturën dhe pas plotësimit të pyetësit ai është nënshkruar nga Drejtori i atij Institucioni.

Pasi përfundimit të hulumtimit në teren, pyetësi është plotësuar, dhe zyrtari përgjegjës i Regjionit i ka dorëzuar në MSh.

- **INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE TË TRAJTUARA NË HULUMTIM**

Më poshtë keni hulumtimin të prezentuar me tabela, grafikone dhe përqindje

NIVELET:		QKUK	SR	QKM F	QMF/AM F	QSHM	IKSH P & etj	Perqindj a %
Pyetjet:								
1	A është e përshtatshme hyrja nga rruga apo trotuari për në oborr të objektit/institucionit ?	55%	71%	65%	62%	65%	33%	59%
2	A ka parking të rezervuar/shënjësuar për personat me aftësi të kufizuar në oborr apo në afërsi të hyrjes?	0%	30%	24%	18%	10%	0%	14%
3	Nëse po, a janë të parkuara vetura tjera që nuk kanë logon/shenjën e aftësisë së kufizuar?	25%	19%	3%	9%	8%	0%	11%
4	A ka pjerrinë/rampë apo platformë lëvizëse në hyrje?	39%	74%	71%	44%	60%	33%	54%
5	Nëse ka pjerrinë/rampë, a është me standard pjerrtësia 6%?	32%	38%	31%	25%	25%	0%	25%
6	A ka pjerrina/rampa mbajtëse anësore?	32%	21%	22%	16%	11%	0%	17%
7	Nëse objekti ka shkallë në hyrje a ka mbajtëse anësore?	30%	21%	19%	12%	10%	19%	19%
8	A ka tualeti hapësirë të mjaftueshme për personat me aftësi të kufizuar, derë të përshtatshme për përdorues të karrocës?	25%	26%	32%	28%	41%	0%	25%
9	A ka tualeti guac tualeti?	38%	48%	52%	32%	62%	55%	48%
10	Nëse po, a ka mbajtëse anësore?	18%	5%	6%	5%	14%	2%	8%
11	Objekti a ka më shumë se 1 kat?	92%	62%	73%	10%	47%	10%	49%
12	Nëse po, a ka lift/ashensor për katet e larta?	92%	45%	12%	1%	7%	1%	26%
13	A është e përshtatshme hapësira deri te	67%	34%	21%	1%	7%	1%	22%

	lifti/ashensori?							
1 4	A është e përshtatshme hapësira e brendshme e liftit/ashensorit?	75%	33%	12%	1%	7%	1%	22%
1 5	A ka sportele për ofrim të shërbimeve / tabela të shpalljeve?	45%	41%	67%	59%	67%	59%	56%
1 6	A ka aksesore fizik për ecje/orientim për persona të verbër?	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
1 7	A ka aksesore audio/zanor (tinguj) orientues për persona të verbër?	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
1 8	A ishin të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuar?	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
1 9	Pengesat tjera në hapësirat e brendshme?	14%	14%	18%	10%	0%	0%	9%
E PERGJITHSHME:		36%	31%	28%	18%	23%	11%	24%
MESATARJA:		24%						




MESATARJA:	24%
-------------------	------------




REGJIONET:




Pyetjet:	Prishtina	Mitrovica	Peja	Gjakova	Prizreni	Ferizaj	Gjilani	Perqindja %	
1	A është e përshtatshme hyrja nga rruga apo trotuari për në oborr të objektit/institucionit?	74%	97%	88%	68%	80%	49%	53%	73%
2	A ka parking të rezervuar/shënjestuar për personat me aftësi të kufizuar në oborr apo në afërsi të hyrjes?	32%	9%	56%	2%	12%	0%	34%	21%
3	Nëse po, a janë të parkuara vetura tjera që nuk kanë logon/shenjën e aftësisë së kufizuar?	11%	12%	16%	2%	10%	11%	17%	11%
4	A ka pjerrinë/rampë apo platformë lëvizëse në hyrje?	53%	52%	54%	44%	67%	20%	53%	49%
5	Nëse ka pjerrinë/rampë, a është me standard pjerrtësia 6%?	40%	39%	44%	29%	47%	9%	28%	34%
6	A ka pjerrina/rampa	30%	30%	25%	16%	23%	6%	11%	20%




	mbajtëse anësore?								
7	Nëse objekti ka shkallë në hyrje a ka mbajtëse anësore?	30%	36%	28%	18%	22%	14%	16%	23%
8	A ka tualeti hapësirë të mjaftueshme për personat me aftësi të kufizuara, derë të përshtatshme për përdorues të karrocës?	46%	55%	25%	19%	46%	17%	13%	32%
9	A ka tualeti guacë tualeti?	56%	91%	44%	55%	76%	63%	52%	62%
10	Nëse po, a ka mbajtëse anësore?	16%	15%	1%	2%	4%	3%	5%	7%
11	Objekti a ka më shumë se 1 kat?	44%	15%	22%	13%	25%	20%	53%	27%
12	Nëse po, a ka lift/ashensor për katet e larta?	23%	9%	6%	0%	7%	0%	33%	11%
13	A është e përshtatshme hapësira deri te lifti/ashensori?	18%	6%	6%	0%	11%	0%	22%	9%
14	A është e përshtatshme hapësira e brendshme e liftit/ashensorit?	19%	12%	4%	0%	7%	3%	20%	9%
15	A ka sportele për ofrim të shërbimeve / tabela të shpalljeve?	75%	82%	69%	52%	51%	46%	34%	58%
16	A ka aksesore fizik për ecje/orientim për persona të verbër?	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
17	A ka aksesore audio/zanor (tinguj) orientues për persona të verbër?	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
18	A ishin të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara?	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
19	Pengesat tjera në hapësirat e brendshme?	7%	6%	1%	19%	23%	0%	11%	10%
20	PERGJITHSHME:	30%	30%	26%	18%	27%	14%	24%	24%
21	MESATARJA:	24%							




**MESATARJ
A:** 24%
























- **PYETËSORI I PËRDORUR GJATË HULUMTIMIT**

Më poshtë keni të prezantuar formën e pyetësit që është përdorur gjatë hulumtimit dhe i cili është plotësuar nga të gjitha IPSH-të.

PYETËSOR

PËR VLERËSIM TË QASSHMËRISË SË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË OBJEKTET PUBLIKE SHËNDETËSORE

TË DHËNAT MBI OBJEKTIN:	
Komuna/Qyteti :	Datë : / / 2015
_____	_____
QKMF :	KLINIKA/INSTITUTI :
_____	_____
QMF :	SPITALI REGJIONAL:
_____	_____
AMF :	Departamenti/Reparti :
_____	_____
Shërbimi :	Amb. Specialistike :
_____	_____
Shërbim tjetër :	Shërbim tjetër :
_____	_____
INSTITUCION TJETËR :	Shërbimi :
_____	_____

Qasja në oborr/hapësirë afër hyrjes :

1. A është e përshtatshme hyrja nga rruga apo trotuari për në oborr të objektit/institucionit?

Po Jo Pjesërisht

Nëse Jo / Pjesërisht, pse? _____

2. A ka parking të rezervuar/shënjëzuar për personat me aftësi të kufizuar në oborr apo në afërsi të hyrjes?

Po Jo

3. Nëse po, a janë të parkuara vetura tjera që nuk kanë logon/shenjën e aftësisë së kufizuar?

Po Jo

Qasja për në objekt/institucion:

4. A ka pjerrinë/rampë apo platformë lëvizëse në hyrje?

Po Jo **Koment:** _____

5. Nëse ka pjerrinë/rampë, a është me standard pjerrtësia 6%?

Po Jo

6. A ka pjerrina/rampa mbajtëse anësore?

Po Jo

7. Nëse objekti ka shkallë në hyrje a ka mbajtëse anësore?

Po Jo

Nëse po, a janë në të dy anët: _____

Qasja brenda objektit/institucionit:

8. A ka tualeti hapësirë të mjaftueshme për personat me aftësi të kufizuar, derë të përshtatshme për përdorues të karrocës:

Po Jo **Koment:** _____

9. A ka tualeti guacë tualeti: Po Jo

10. Nëse po, a ka mbajtëse anësore: Po Jo

11. Objekti a ka më shumë se 1 kat: Po Jo

12. Nëse po, a ka lift/ashensor për katet e larta: Po Jo

13. A është e përshtatshme hapësira deri te lifti/ashensori:

Po Jo **Koment:** _____

14. A është e përshtatshme hapësira e brendshme e liftit/ashensorit:

Po Jo **Koment:** _____

Nëse nuk ka lift, shkallët e kanë mbajtëse anësore në të dy anët: _____

15. A ka sportele për ofrim të shërbimeve / tabela të shpalljeve:

Po Jo

16. A ka aksesore fizik për ecje/orientim për persona të verbër?

Po Jo **Koment:** _____

17. A ka aksesore audio/zanor (tinguj) orientues për persona të verbër?

Po Jo **Koment:** _____

18. A ishin të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuar:

Po Jo **Koment:** _____

19. Pengesat tjera në hapësirat e brendshme:

Po Jo

Nëse po, përshkruaj: _____

Personi përgjegjës i institucionit:

(Emër dhe Mbiemër)

(Pozita)

Pyetësi u plotësua nga:

(Emër dhe Mbiemër)

(Pozita)

KONKLUZIONI NGA HULUMTIMI

Duke u bazuar në përqindjen e vogël dhe jo të kënaqshme të qasjes në institucionet publike shëndetësore ky hulumtim do ti shërbej institucioneve të Republikës së Kosovës, gjegjësisht Institucioneve Shëndetësore si dhe investitorëve të tjerë, që në të ardhmen të përmirësohet qasshmëria fizike në objektet e IPSH për PAK, sepse pa qasje në shërbime për të gjithë qytetaret nuk ka shoqëri gjithëpërfshirëse.